



Drejtuar: OST SHA

Objekti: Njoftim per terheqje te ofertes se shoqerise ReNGY Trading Group Shpk. per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e transmetimit per periudhen 01-30 Nentor 2020.

Tirane me 28.10.2020

Te nderuar Zonja, Zoterinj,

Ju drejtohem ne vijim te procedures se prokurimit publik te kryer nga OST Sha. me date 28.10.2020 per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e transmetimit per periudhen 01-30 nentor 2020. Sipas njoftimit te OST Sha., te dates 28.10.2020, ora 12.37, ReNGY Trading Group Shpk. kishte oferten me te mire per prokurimin e lartpermendur.

Nderkohe, po ne date 28.10.2020, ne oren 15.49 (pra pas procedurave te prokurimit) njoftohemi nga OST se “ne lidhje me alokimin e kapaciteteve per muajin Nentor sot kemi marre nje e-mail nga ENTSO-E, ku EMS ka deklaruar qe per muajin Nentor 2020 nuk do te zhvilloje alokim te kapaciteteve ne kufirin AL-RS dhe si pasoje nuk mund te pranoje alokimin e kapaciteteve e zhvilluar nga ana jone dhe as nuk do pranoje nominimet ne kufirin AL-RS.

Ne keto kushte njoftoheni per te bere vleresimet tuaja dhe rakordimet me partneret tuaj ne lidhje me transaksionet dhe perdorimin e te drejtes se transmetimit te alokuar nga OST sh.a. pasi per arsyen e permendur me siper e drejta e transmetimit e alokuar mund te mos behet efektive”.

Sic jeni ne dijeni, ReNGY Trading Group Shpk. ka marre pjese ne ankadin e zhvilluar nga OST Sha. per kapacitetet e transmetimit per AL-RS per periudhen 1-30 nentor 2020 dhe ka blere keto kapacitete nga OST Sha.

Pezullimi nga EMS i te drejtes se transmetimit, livrimit dhe pranimit te nominimeve sipas prokurimit te lartpermendur prek levrimin sipas ketij prokurimi. Ky pezullim eshte nje ngjarje qe ReNGY Trading Group Shpk. nuk mund ta shmange apo shmange, apo ta kapercente apo kaperceje dhe ben te pamundur qe te livrohete energjia sipas prokurimit ne fjale. Per pasoje, ky pezullim eshte nje rast force madhore qe e ben te pamundur permbushjen nga ana e ReNGY Trading Group Shpk. te Aneks kontrates per prokurimin ne fjale pasi te nenshkruhet.

Ne keto kushte, njoftojme qe per shkak te kesaj force madhore, nuk do te mund te nenshkruajme Aneksin per kete prokurim, pasi ne rrethanen e pezullimit te te drejtes se transmetimit RS-AL nuk do te mund te livrojme energjine ne fjale dhe kerkojme qe te ndermerrni procedurat per anullimin e ketij prokurimi.




E bejme kete duke ndjekur udhezimet tuaja sipas emailit te siperpermendur si dhe parimin e mirebesimit ne marredheniet kontraktore.

Mbetemi ne pritje te konfirmimit tuaj per anulimin e procedures se prokurimit per mbulimin e humbjeve ne rrjetin e transmetimit per periudhen 01-30 Nentor 2020.

Nderime,

ReNRGY Trading Group Shpk.

A large, stylized handwritten signature in blue ink, consisting of a large loop on the left and a vertical line on the right with a wavy flourish at the top.

Anisa Skendaj
Drejtorese e pergjithshme

